

197.93€ nga të cilat kemi: shitjet e tatueshme me normën 18% në vlerë prej 291,276.66€ si dhe shitjet e tatueshme me normën 8% në vlerë prej 8,921.27€b dhe konstatim të mallrave pa origjinë në vlerë prej (12,316.09*25%) 3,079.02€ shqiptim i ndëshkimit. Kontrolli i bërë dhe çarkullimi shtesë në vlerë prej 300,197.93€ është i papranuar pasi që vlera prej 264,226.47 € janë produkte të projektit që është faturuar si avans me 15.06.2022 duhet të bëhen dalje produktet dhe të thyhet avansi për shitjen që janë realizuar.Stoqet ne listën e diferencave të kontrolli është me 30.09.2022, që janë produkte të projektit. Vlera e tatueshme me 18 %-260,296.06 € ,Vlera e tatueshme me 8 %-3930.41 €.Ndërsa diferenca tjetër e mbetur 35,969.56 janë disa produkte të cilat kemi bërë edhe ankesë që nuk janë numëruar mirë, pasi që në numërim të stoqeve atë ditë ka qenë një punëtorë i ri qe ende nuk i ka mësuar produktet mirë dhe ka pasur gabime teknike gjatë numërimit të stokut. Vlera e tatueshme me 18 %-30,978.69€.Vlera e tatueshme me 8 %-4,990.87€. Sa i përket diferencave të paraqitura në stoqe në vlerë prej 300, 197.93€ vlerë shitëse dhe mungesë të stoqeve në vlerë të kostos 228,774.50€ në Raportin e Kontrollit si që edhe i kemi njoftuar edhe personat që kanë qenë gjatë kontrolli është që lista e diferencave te stoqeve ka të bëjë me kontratën në mes të [REDACTED] Besa Security L.L.C dhe Besa Security SH.P.K në total vlerë [REDACTED] Besa Security L.L.C dhe Oendrës Tregtare të re Prishtina Mall. Sa i përket kësaj kontrate pra shitje nga [REDACTED] Besa Security L.L.C dhe Besa Security SH.P.K në total vlerë [REDACTED] prej 475,411.23€ me TVSH. Kjo kontratë ka filluar të jetë aktive në momentin që [REDACTED] Besa Security L.L.C ka filluar të furnizohet me furnizim të mallit për këtë kemi pranuar avanse të pranuara nga Besa Security SH.P.K si dhe janë faturuar nga [REDACTED] Besa Security L.L.C dhe Besa Security SH.P.K në total vlerë të pranuara Më poshtë gjeni listën e avanseve të pranuara dhe të faturuara prej 259,332.00€. Projekti ka filluar dhe Besa Security SH.P.K ka pasur probleme financiare dhe ka kërkuar financim nga Bankat për këtë projekt dhe pasi që e kanë financuar kanë kërkuar faturën nga [REDACTED] Besa Security L.L.C që të realizohet fatura komplet për të gjithë projektin dhe pastaj realizohet transferi në [REDACTED] Besa Security L.L.C në mënyrë automatike nga banka. Transferimi është realizuar me 15.06.2022 ku është bërë fatura në vlerë të tatueshme prej 402,890.87€ pra vlera me TVSH 475,411.23 €, në këtë datë është pranuar edhe transferimi bankar. Kjo faturë është faturuar vetëm si avans pasi që produktet ende nuk janë pranuar pasi qe importet janë pranuar gradualisht. I është bërë anulimi për avanset që janë faturuar në data të ndryshme dhe janë kthyer mjartet me transferim bankar dt.15.06.2022 -259,332.84€.Pasi që projekti ka qenë në një kontratë me vlerë të madhe si dhe produktet për këtë projekt kanë ardhur gradualisht dhe brendshme të Prishtina Mall, për këto produkte të kontratës që janë dërguar tek klienti për realizim të kontratës në mënyre që ta kontrollojmë projektin më lehtë i kemi kaluar me lëvizje interne në një objekt të ri te gjitha produktet që janë dërguar tek klienti dhe pastaj të bëhet fatura dalje të stoqeve dhe thyerjen e avansit për vlerën totale te projektit. Kjo po ashtu qe produktet kanë qenë disa me 8% dhe disa me 18% dhe nuk kemi mundur qe ti faturojmë saktë pa u importuar komplet produktet. Vlera e projektit është 475,411.23 € për këtë avans është deklaruar TVSH vetëm 18% që pastaj kur të behet thyerja te identifikohen produktet me 18 % si dhe me 8%. Sa i përket vlerës të stoqeve të këtij projekti që janë paraqitur në Raportin e Kontrolli është me 30.09.2022 vlera prej 264,226.47 € janë produkte të projektit më lartë që duhet të bëhen dalje dhe të thyhet avansim për shitjen që është realizuar. Vlera e tatueshme me 18 %- 260,296.06 €,vlera e tatueshme me 8 % -3930.41 €.Ne kërkojmë nga ju që ta keni parasysh dhe te trajtohet në mënyre profesionale ky problem pasi nëse ne obligohemi qe te behet shitja për këto produkte ne obligohemi praps ti importojmë në mënyrë që ta realizojmë faturën pra mbylljen e avansit për produkte të këtij projekti pasi që në aspektin financiarë është realizuar shitja dhe është deklaruar TVSH-ja për këto produkte. Më

poshtë gjeni listën e stoqeve të cilat janë kërkuar të bëhen shitje nga Kontrolli me 30.09.2022 që janë produkte të kontratës së projektit pra vlera prej 264,226.47€. Ndërsa diferenca tjetër e mbetur 35,969.56€ janë disa produkte të cilat ka pasur gabime teknike gjatë numërimit të stokut po ashtu është sasi e madhe e stokut dhe gjasat për permutacion janë të mundshme, pasi kemi vërejtur diferenca +1-1 ku ka pasur ndonjë gabim gjate faturimit. Vlera e tatueshme me 18 %- 30,978.69€ Vlera e tatueshme me 8 %-4,990.87 €.Ne Opinionin dhe arsyet e tatimpaguesit janë cekur disa ankesa për disa produkte për te cilat kemi mundur që ti kontrollojmë dhe çka kemi mundur me vërejt si gabime. Ankesa lidhur me diferencën për artikullin me nr. 345, sipas numërimit te datës 26.08.2022 ky artikull është numëruar duke u përfshire sasi të nga dy numrat rendore 53 dhe 132 nga ka rrjedhur dhe rezultati. Artikulli me nr.1168 nëse është numëruar gabim apo është ngatërruar nga punëtorët e biznesit, duhej te behej evidentimi deri ne fund te vizitës kur është mbyllur numërimi dhe janë nënshkruar listat e verifikimit. Artikulli me nr.1109, gjendja ne stok te printuar nga ana e T/P ishte 224 copë ndërsa sipas numëronit te punëtorëve përgjegjës për numrin nga ana T/P sasia ne moment te verifikimit ishte 245 cope. Artikulli me nr. 1023 i cili ka rezultuar ne mungesë sipas verifikimit ne momentin e vizitës nuk ka qenë ne depo dhe pse figuronte ne stok, sa i përket kontratës se prezantuar që në shërbim nga KQZ ishin 2 skaner dhe kohëzgjatja e kontratës ishte deri me 20.12.2021, që nënkupton se ne datën e vizitës ky artikull nuk ishte më ne shërbim dhe duhej te ishte ne formën fizike ne depon e tatimpaguesit. Po ashtu pas pranimit te raportit kemi bërë regjistrim për mallin dhe kemi vërejtur qe nuk është regjistruar malli ne gjendje të saktë pasi që edhe produktet nuk kanë ditur që ti identifikojnë pasi që ka qenë punëtori i ri. Sa i përket Vendimit mbi shqiptimin e ndëshkimit administrative ne vlere prej 3079.02 € të Nenit 59 për konstatim të mallrave pa origjinë në vlerë prej (12,316.09*25%) 3,079.02€ kundërshtojmë këtë vlerë pasi që nuk kemi mallra pa origjinë pasi të gjitha produktet janë te importuara pra kemi DUD (Dokumentin Unik Doganorë) kjo ka ndodhur për gabime teknike gjatë numërimit të stoqeve dhe mos identifikimi i saktë i artikujve. Pra nga të gjitha faktet e prezantuar kërkojmë nga ATK , Departamenti i Ankesave të bëjë anulimin e kontrolli es të datës 30.09.2022 dhe të na lejoj deklarimet e bëra në afat ligjorë.

Vlerësimi i kontrollit : Tatimpaguesi nuk ka pasur kontroll paraprake. Për zgjedhja e rastit është bazuar nga Vizita për mbushëse dt.26.08.2022 për verifikim të stoqeve. Me procedurë kontrollit e cila ka fillua dt.22.09.2022 është periudha e TVSH-së 08/2022. Ne vizitën e realizuar me date 26.08.2022 është kërkuar prezantimi i stokut momental, ku të gjitha shitjet dhe blerjet deri ne moment te vizitës janë te regjistruara dhe deklaruar ne libra dhe gjendja e stokut është ne rregull sipas atij qe figuron ne këtë datë. Pas prezantimit te evidencës se gjendjes se stokut momental te datës 26.08.2022 ne vlere prej 722,171.71 €, ku sipas prezantimit te listës së stokut momental nga T/P është kryer verifikimi i stokut momental (në formë mos trimi). Dhe nga një verifikim i këtille janë konstatuar diferenca, nga ka rrjedhur mungese ne stoqe dhe disa artikuj teprice ne stoqe.

Bazuar ne verifikimin e kryer ka rrjedhur mungesë e stoqeve në vlerë te kostos 228,774.56€, te cilat sipas kontrollit janë trajtuar si nen deklarim në qarkullim ne vlere totale prej 268,167.02€ me shprehje: Shitjet e tatueshme me normën 18% ne vlere prej 291,276.66€ si dhe Shitjet e tatueshme me normën 8% ne vlerë prej 8,921.27€.Vlera e mallit pa origjinë 12,316.09€ dhe blerjet me shprehje 25% 3,079.02€ Obligimi tatimor ka rezultuar për periudhën e kontrollit TVSH-së 08/2022 obligimi tatimor prej 47,918.55€ ,zbritje e kreditimit 12,268.89€.

Divizioni i Ankesave për shqyrtim më detal të ankesës ka mbajtur seancën dëgjimore me datë 14.11.2022 në bazë të nenit 95, të ligjit nr.05/L- 031 Për Procedurën Administrative, në prezencë të palëve në procedurë. Me pëlqimin e palëve nuk u lexua ankesa me shkrim. Përfaqësuesi i tatimpaguesit në të drejtën e fjalës cek se stoqet që janë vlerësuar nën deklarim

300, 197.93€. "Besa Security" I.L. G. ka kontratë në mes të "Besa Security" dhe Qendrës Tregtare të re. Tenderin e ka fituar "Besa Security" Shk dhe ka pasur kërkesë të kompania "Besa Security" për të furnizuar me mall në kontratë. Punëtorët që kanë bërë verifikimin e mallit kanë pasur gabime teknike gjatë verifikimit të produkteve, ka rrjedhë mungesë malli në stoqe dhe ka figurua tepriçë mallit. Artikulli nr.53 dhe nr.132 janë artikuj të njëjtë kur është bërë verifikimi i stokut, kemi dëshmi se numërimi nuk ka qenë i saktë. Produkti 1168 gabim numërimi, produkti 1109 në stok është nr.245 janë evidentua vetëm 224 (produkte të njëjta), produkti me nr.1023 ka rezultuar mungesë, kanë qenë me qira te KQZ, kur kanë përfundua zgjedhjet nuk e kanë marrë. Kontrata për "Besa Security" janë artikujt e posaçëm. "Besa Security" I.L. G. angazhuar për furnizim komplet të mallit.

Inspektori në të drejtën e fjalës theksoi se kemi bërë verifikimin e stokut-mallit për subjektin "Besa Security" I.L. G. se janë punëtorët të cilët e njohin stokun dhe janë të gatshëm për verifikim, është ofrua stoku, ku kemi bërë verifikimin në disa raste e kemi cek se të verifikohet edhe njëherë apo dy herë dhe vlera e mallit ka dalë mungesë dhe tepriçë. Për saktësinë e mallit është njoftuar edhe pronari, për ndryshimet mungesë dhe tepriçë të mallit ai ka deklaruar se punëtorët janë në ngjarje dhe ata e dinë si është gjendja e stokut. Fatura "Besa Security" I.L. G. për mallin të kontratës nr. 300, 197.93€.

Administrata Tatimore e Kosovës - Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit të ankesës, seancës dëgjimore dhe pas administrimit, vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës, paneli vlerësoi se ankesa e subjektit në procedurë është e pa bazuar.

Dispozitivi i këtij vendimi është i mbështetur në faktet në vijim:

Divizioni Ankesave pas vlerësimit të provave materiale në shkresat e lëndës si: Aktiviteti, Formë për vizitën e përmbushjes dt. 26 /08/2022, stokun momental të prezantuar apo të printuar nga tatimpaguesi me dt.26.08.2022 dhe bazuar në verifikimin e tij në formë mos trimi në mungesën e rrjedhur të stoqeve si qarkullim shtesë në vlerë totale prej 300, 197.93€ nga të cilat kemi: shitjet e tatueshme me normën 18% në vlerë prej 291,276.66 € si dhe shitjet e tatueshme me normën 8% në vlerë prej 8,921.27 €. Vlera e mallit pa origjinë 12,316.09€ dhe ndëshkimi 25% 3,0789.02€. Fatura nr. 476/210/001/22 dt. 26.08.2022, llogarinë bankare, Raportin e Kontrollit dt. 29.09.2022, Njoftim Rivlerësimit pas kontrollit periudha TVSH 08/2022, lista e stokut në formë të exell-it, në Depo kryesore dhe Prishtina mall e përcjellë nga tatimpaguesi me procedurë kontrolli dt.29.08.2022, analizimit të pretendimeve ankimore të tatimpaguesit se nga lista e stoqeve që janë kërkuar të bëhen shitje sipas kontrolli është dt.30.09.2022 se janë produkte të kontratës së projektit vlera prej 264,226.47€-paraqitja listës së produkteve, diferencën prej 35,969.56€ dhe gjatë ecurisë së shqyrtimit të ankesës, në nivelin e mëpastajshëm të Divizionit të Ankesave tatimpaguesi ka prezantuar dokumentin material- faturën e dt. 07.09.2022 dhe arsyetuar mungesën e rrjedhur të stoqeve se është dokumentacion i pranueshëm.

Divizioni i Ankesave mbi bazën e të dhënave të vizitës për mbushëse dt.26.08.2022 konfirmon se mungesa e stoqeve ka rrjedhur nga analiza materiale e mallit dhe me qarkullim shtesë në vlerë totale prej 300, 197.93€ dhe vlera e mallit pa origjinë 12,316.09€, biznesi operon vetëm me një njësi e cila gjendet në Veternik -Prishtinë ku dhe është realizuar vizita e

dt.26.08.2022, sipas tatimpaguesit nuk posedon njësi tjetër, shitjet dhe blerjet deri në momentin e vizitës janë të regjistruara dhe gjendja e stokut është në rregull me këtë datë 26.08.2022. Andaj, lidhur me procedurën e verifikimit fizik të mallit nga përfaqësuesit e biznesit konstatohet se nuk kanë pasur vërejtje, konfirmohet me nënshkrimet e tyre në listën zyrtare të verifikimit të aplikuar.

Duke i bërë analizë Faturës nr.478-210-001-22 dt.15.06.2022 e cila faturë është përcjellë nga tatimpaguesi në procedurë të kontrollit, fatura në fjalë sipas Divizionit të Ankesave nuk konsiderohet si e rregullt pasi nuk i përmban të dhënat e përcaktuara sipas paragrafit 1.6 të nenit 45 të Ligjit Nr.05/L-037 pasi nuk i ka të paraqitura të dhënat e sasisë dhe natyrën e mallrave të furnizuara.

Pretendimet e tatimpaguesit ku jepen sqarime në lidhje me kontratën në mes të BESA Security SH.P.K dhe Dendës Trëhtarë të re Prishtinë Mall Shitie nga BESA Security I.I.G. si dhe Dendës Trëhtarë të re Prishtinë Mall Shitie nga BESA Security SH.P.K në total është kontrata në vlerë prej 4.259.332 me Tvsh, kemi pranuar avanse të pagesave nga BESA Security SH.P.K si dhe janë faturuar nga BESA Security SH.P.K në vlerë prej 259.332.00€.

Gjithashtu sqarohet se transferimi bankar është realizuar me 15.06.2022 ku është bërë fatura në vlerë të tatueshme prej 259.332.00€ me TVSH 478-210-001-22 është bërë anulimi për avansë që janë faturuar dhe deklaruar në data të ndryshme dhe janë kthyer mjetet me transferim bankar dt.15.06.2022 (259.332.00€). Divizioni i Ankesave mbi bazën e këtyre sqarimeve ka konfirmuar se avanset e pranuar të datave 28.02.2022,04.03.2022,25.03.2022,30.03.2022,06.04.2022 dhe 05.05.2022 në vlerë prej 259,332.00€ janë të deklaruara në periudhat përkatëse dhe me të drejtë është bërë thyerja financiarisht me Faturën nr.478-210-001-22. Diferenca e mbetur është e deklaruar në periudhën 06/2022. Në procedurë të Ankesave tatimpaguesi ka sjellë Kontratën e dt.17.02.2022 të lidhur në mes të BESA Security I.I.G. dhe Dendës Trëhtarë të re Prishtinë Mall Shitie nga BESA Security SH.P.K.

faktikisht gjatë analizës së Kontratës lidhur me kontestin, nuk janë të përshkruara shifrat-kodet e artikujve që figurojnë në llager listë që ka mbajtur evidencën e stoqeve për të krahasuar evidencën e mallit në te, e që përfundimisht për të krahasuar me mungesën e konstatuar në vlerë totale prej 300, 197.93€ dhe vlera e mallit pa origjinë 12,316.09€.

Sipas pretendimit të tatimpaguesit, provën të përcjellë me kontroll dt.29.08.2022 listën e stokut në formë të exellit për Fletë dërgesë në vlerë 133,853.07€, në Depo kryesore në vlerë 586,697.31€ dhe se sipas ankesës me shkrim të përshkruar në formën tabelore janë produkte të kontratës së projektit vlera prej 264,226.47€,paraqitja listës së produkteve diferenca prej 35,969.56€. Sipas Divizionit të Ankesave këto të dhëna –vlera të prezantuara si në ankesën me shkrim dhe me procedurë kontrolli nuk përputhen mes vete, nuk janë prova materiale, fakte të besueshme pasi tatimpaguesi nuk ka ofruar evidencë të dokumentuar të pranueshme, burimore për mungesën e mallrave, mallit pa origjinë si që kërkon dispozita Ligjore UA Nr.15/2010 neni 19 paragrafi 1.2- Fletë dërgesë e cila është një dokument mbështetës për mallrat të cilat janë transportuar në vend dhe janë destinuar për një destinacion të specifikuar –blerës, pranues vend deponim etj. ku e drejta pronësore kalon nga shitësi te blerësi.

Sipas opinionit të tatimpaguesit se gjatë verifikimit të produkteve ka pasur gabime teknike për artikullin me nr. 345, sipas numërimit të datës 26.08.2022 ky artikull është numëruar duke u përfshirë sasisë nga dy numrat rendore 53 dhe 132 nga ka rrjedhur dhe rezultati. Nga Divizioni i Ankesave është verifikua artikulli me nr. 345 sipas numërimit të datës 26.08.2022 dhe konstatohet se në llager listën e ofruar nga vet tatimpaguesi në dy numrat rendore 53 dhe 132 ka pasur evidencë artikulli me nr. 345,por konfirmohet se artikulli me nr. 345 në numrin rendore 53 nuk është konstatuar as mungesë as tepriçë të artikullit, por vetëm artikulli me nr. 345 në numrin rendore 132 ka mall pa origjinë në vlerë 4,856.35€.

Artikulli me nr.1168 nëse është numëruar gabim apo është ngatërruar nga punëtorët e biznesit, duhej të bëhej evidentimi deri në fund të vizitës kur është mbyllur numërimi dhe janë nënshkruar listat e verifikimit. Divizioni i Ankesave nga analizimi i listës së numërimit të mallit datë 26.08.2022, konfirmohet lista në fund të vizitës me nënshkrimet e tyre dhe se Artikulli me nr.1168 është konstatuar mall pa origjinë 1 copë x 3,017.22€.

Artikulli me nr.1109, gjendja në stok të printuar nga ana e T/P ishte 224 cope ndërsa sipas numërimit të punëtorëve përgjegjës për numrin nga ana T/P sasia në moment të verifikimit ishte 245 cope. Është e saktë pasi ka bërë konfirmimin Divizioni i Ankesave se nga ana e T/P ishin 224 cope, ndërsa në moment të verifikimit ishin 245 cope dhe është vlerësua si me mall pa origjinë 21 copë në vlerë 1,190.85€.

Artikulli me nr. 1023 i cili ka rezultuar në mungesë në momentin e vizitës nuk ka qenë në depo dhe pse figuronte në stok, kanë qenë në shërbim nga KQZ për 2 skanerë dhe, kohëzgjatja e kontratës ishte deri më 20.12.2021, që nënkupton se në datën e vizitës ky artikull nuk ishte më në shërbim dhe duhej të ishte në formën fizike në depon e tatimpaguesit. Sipas Divizionit të Ankesave vërtetohet se edhe vet tatimpaguesi e ka dëshmuar se në datën e vizitës gjatë verifikimit të mallit, artikulli me nr. 1023 përveç në llager listë të tatimpaguesit do të duhej të ishte në formën fizike në depon e tatimpaguesit për të cilin ka rezultuar mungesa.

Gjatë ecurisë së shqyrtimit të ankesës, në nivelin e mëpastajshëm të Divizionit të Ankesave tatimpaguesi ka prezantuar dokumentin material- faturën që " [redacted] " ka faturuar " [redacted] " SH.P.K dt.07.09.2022 nr. 807-210-001-22 me përshkrimin e artikujve, sasive me çmimet dhe vlerat përkatëse duke e arsyetuar mungesën e njëdhur të stoqeve. Divizionin e Ankesave e kufizon neni 14 paragrafi 7 dhe 8 i Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe neni 28 paragrafi 3.1 i UA 15/20210 me këtë informatë dhe dokumentacion shtesë. Sa për analizë Divizioni i Ankesave ka verifikuar artikujt sipas faturës dt.07.09.2022 nr. 807-210-001-22 në vlerë 475,411.11€ dhe artikujt sipas listës së regjistrimit të mallit dt. 26.08.2022 dhe konstatohet se vetëm artikujt me nr.1184, 163, 1187, 1194, 1210, 1211, 1214, 1216, 1224, 1226, 1228, 1229, 1180, 1161, 287 në vlerë financiare prej 173,804,44€ sipas çmimit shitës pa TVSH që janë krahasuar nga kontrolli mungesë, ndërsa artikujt tjerë sipas faturës nuk janë krahasuar me kontroll. Vlen të potencohet, se artikujt nr.1127,1156,1168 sipas faturës në fjalë dhe duke e krahasuar listën e regjistrimit të mallit dt. 26.08.2022 konstatohet se këta artikuj janë vlerësuar si mall pa origjinë. Gjithashtu, për analizë Divizioni i Ankesave ka krahasuar artikujt sipas listës së stokur dt.29.08.2022 në formë të exellit për Prishtina mall në vlerë 133,853.07€ dhe listës së regjistrimit të mallit dt. 26.08.2022 dhe konstatohet se vetëm artikujt me nr.1184,1157,1194,1127,1022,163,340,351,1192,287 në vlerë financiare prej 96,469.59€ sipas çmimit shitës pa TVSH që janë krahasuar nga kontrolli mungesë, ndërsa artikujt tjerë sipas listës në exell nuk janë krahasuar me kontroll. Potencohet se artikulli nr.345 sipas listës së stokut dt.29.08.2022 dhe duke e krahasuar listën e regjistrimit të mallit dt.26.08.2022 konstatohet se ky artikull është vlerësuar si mall pa origjinë dhe artikujt nr.1186 dhe 1197 nuk është konstatuar as mungesë të mallit dhe as mall pa origjinë.

Sa i përket kundërshtimit të Vendimit mbi shqiptimin e ndëshkimit administrative në vlerë prej 3079.02€ të Nenit 59 për konstatim të mallrave pa origjinë në vlerë prej (12,316.09*25%) 3,079.02€ pasi potencon që nuk kemi mallra pa origjinë pasi të gjitha produktet janë të importuara pra kemi DUD (Dokumentin Unik Doganore).Sipas Divizionit të Ankesave tatimpaguesi nuk ka qenë në gjendje të arsyetoj prejardhjen e këtij malli nga koha e pranimit qoftë përmes importimit, blerjes, shërbimit apo mënyrave tjera. Tatimpaguesi nuk ka arritur të dëshmoj të kundërtën e vlerësimit tatimor me prova materiale bindëse bazuar në paragrafin 6 të nenit 19 të Ligjit nr.03/L- 222, pasi tatimpaguesi ka barrën e provës lidhur me të provuarit se kryerja e ndonjë vlerësimi të tillë është i pa saktë.

Divizioni i Ankesave vlerëson se pretendimet e tatimpaguesit në ankesë nuk paraqesin argumente të mjaftueshme bindëse dhe esenciale për të ndryshuar Njoftim Vlerësimin e tatimit shtesë të caktuar me kontroll, prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkrësive të lëndës dhe ballafaqimit të provave, Divizioni i Ankesave konstaton se Vendimi mbi Njoftim Vlerësimin e tatimit shtesë të caktuar për periudhën 08/2022 TVSH nga Rajoni Prishtina i është i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi të ATK-së.

Andaj, për pa rregullsitë e konstatuara në vlerësim të kontrollit, ndëshkimet dhe interesi rrjedhin në bazë të Nenit 51.1 dhe 28.1 dhe të Nenit 52 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat".

Në bazë të gjendjes së konstatuar duke pasur parasysh të gjitha provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e në përputhje me nenin 132, pika (2), të Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L- 031, Departamenti i Ankesave e vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222. Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, tatimpaguesi i pa kënaqur ka të drejtën që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim në Divizionin Fiskal të Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË

Nr: 461/2022 datë 08.12.2022

Vendimi t'u dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi _____

Kryesuese e panelit
Ylber Fazliu _____

